

L I G J
Nr.9513, datë 10.4.2006

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR.9268, DATË 29.7.2004 “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AUTORITETIT MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.9268, datë 29.7.2004 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Shkronja “b” e nenit 7 ndryshohet si më poshtë:
“b) Kryetari”.

Neni 2

Neni 8 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 8

Këshilli i Autoritetit është organ kolegjal. Ai vendos për politikat në lidhje me realizimin e objektivave të Autoritetit. Këshilli përbëhet nga Kryetari dhe nga gjashtë anëtarë. Anëtarët e Këshillit nuk mund të punësohen në Autoritet.”.

Neni 3

Neni 13 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 13

Anëtari i Këshillit të Autoritetit përfiton një shpërblim mujor të barabartë me 30 për qind të pagës së Kryetarit.”.

Neni 4

Pas shkronjës “k” të pikës 2 të nenit 14 shtohet shkronja “l” me këtë përmbajtje:
“l) miraton rregulloren e funksionimit të organit ekzekutiv.”.

Neni 5

Pika 2 e nenit 15 ndryshohet si më poshtë:
“2. Mbledhja e Këshillit thirret dhe drejtohet nga Kryetari, i cili në lajmërimin me shkrim ka përcaktuar më parë rendin e ditës.”.

Neni 6

Pika 2 e nenit 16 shfuqizohet.

Neni 7

Neni 18 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 18

Kompetencat e Kryetarit

Kryetari i Këshillit është edhe Drejtor Ekzekutiv i Autoritetit.

Kryetari, në ushtrimin e funksioneve të veta si Drejtor Ekzekutiv, ka për detyrë:

- a) të drejtojë dhe të përgjigjet për veprimtarinë e Autoritetit, si dhe ta përfaqësojë atë në marrëdhëniet me të tretët;
- b) të nënshkruajë, në emër të Autoritetit, marrëveshjet në fushën e sigurimeve;
- c) të emërojë punonjësit e Autoritetit, në përputhje me strukturën dhe kriteret e miratuara nga Këshilli;
- ç) të ndjekë zbatimin e vendimeve të Këshillit;
- d) të nxjerrë urdhra dhe udhëzime, në zbatim të vendimeve të Këshillit;
- dh) të ushtrojë kompetencat, që i delegohen nga Këshilli.”.

Neni 8

Nenet 19 dhe 20 shfuqizohen.

Neni 9

Në nenet 14 shkronja “j”, 21, 22, 25 pikat 1 e 4, fjalët “Drejtori Ekzekutiv” zëvendësohen me fjalën “Kryetari”.

Neni 10

Pika 3 e nenit 25 ndryshohet si më poshtë:

“3. Funksioni i Kryetarit të Këshillit është i papajtueshëm me çdo funksion tjetër, me përjashtim të funksionit si Drejtor Ekzekutiv i Autoritetit, si dhe me veprimtarinë në fushën e mësimdhënies.”.

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.4847, datë 25.4.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu